



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.0.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Prishtinës në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrë auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Sejdiu, i mbështetur nga udhëheqësja e ekipit, Luljeta Morina dhe anëtarët Qëndresa Sogojeva dhe Elvir Krasniqi.

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|---|----|
| Përmbledhje e përgjithshme..... | 4 |
| 1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm | 7 |
| 2 Qeverisja..... | 12 |
| 3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli..... | 19 |
| Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit | 43 |
| Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP | 44 |
| Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak | 47 |


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Prishtinës për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit, megjithëse bashkëpunimi duhet të jetë dukshëm më i mirë.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat të cilat ne i kemi konsideruar të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 26.10.2015.

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më hollësisht, shih Shtojcën I të këtij raporti).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) për të përfunduar auditimin për vitin 2015 është përcaktuar nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opiniononi

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

“Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes” - për shkak se në bazë të memorandumeve për bashkëfinancime komuna ka paguar 288,565€ në llogari të donatorëve/implementuesve ndërsa nuk ka pranuar ndonjë raport të progresit fizik dhe financiar të projekteve në vitin 2015. Po ashtu, komuna nuk ka arritur t'i regjistrojë pasuritë e saj në SIMFK, një pjesë e investimeve kapitale dhe mallrave dhe shërbimeve ishin keqklasifikuar dhe një pjesë e shpalosjeve nuk ishin të sakta.

Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:

Procesi i regjistrimit dhe vlerësimit të pasurisë është menaxhuar dobët dhe nuk konfirmon plotësinë e pasurisë ndërsa pagesat në llogari të donatorëve dhe keqklasifikimi i shpenzimeve ka rezultuar me theksim të çështjes.



Kryetari duhet t'i analizojë mangësitë në procesin e regjistrimit të pasurisë, arsyet për keq klasifikim të shpenzimeve dhe formën e pagesave për bashkëfinancime dhe t'i identifikojë veprimet që kërkohen për të mundësuar një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të PVF-ve në fund të 2016 (shih pjesët 1.3 dhe 1.4).

Ekzistojnë papajtueshmëri me kërkesat për raportin sepse shpalosjet e PVF-ve përmbajnë gabime dhe mangësi informatash lidhur me llogaritë e pagueshme dhe të arkëtueshme.



Kryetari duhet të sigurojë se plani sistematik i përpilimit të pasqyrave financiare inkorporon kërkesën për të prezantuar vlerat e plota dhe të sakta të llogarive, duke përfshirë edhe shpalosjet. Kryetari duhet të monitorojë zbatimin e kësaj kërkesë (shih pjesën 1.4).

Procesi i vetëvlerësimit dhe përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak nuk po adresohen ashtu siç kërkohet, dhe si pasojë, përmirësimet janë të ngadalshme.



Kryetari në veçanti duhet ta zbatojë një proces rigoroz për të siguruar që rekomandimet maksimalisht implementohen sipas planit dhe çështjet/progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore, duke përfshirë edhe vetëvlerësimin (shih çështjet 3 dhe 4).

Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial nuk janë adekuate. Aktiviteti i auditimit të brendshëm nuk i mbështetë mjaftueshëm zhvillimet në këtë fushë.



Kryetari duhet të sigurojë që aranzhimet e Qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se ka përmirësim të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial dhe ngritje të efektivitetit operativ, të mbështetur nga një NJAB më efektive (shih çështjet 5,6 dhe 7).

Përkundër progresit, ekzistojnë dobësi të mëdha në disa sisteme të rëndësishme financiare duke përfshirë të hyrat prokurimin, shpenzimet pa prokurim, pagat dhe subvencionet.



Kryetari duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të prokurimit dhe fushave tjera sfiduese të theksuara në këtë raport për t'i identifikuar arsyet për shfaqjen e dobësive si dhe veprimet e nevojshme për evitimin e tyre (shih pjesët 3.4, 3.5 dhe 3.6).

Përgjigja e Menaxhmentit në auditimin 2015

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresojë rekomandimet e dhëna.

Ne e konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do ta shqyrtojë raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2017, ta diskutojë në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF-të 2016 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar, për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

PËR KOMUNËN E PRISHTINËS

OPINION I PAMODIFIKUAR ME THEKSIM TË ÇËSHTJES

Ne kemi audituar Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë 'Pasqyrën e Pranimeve dhe të Pagesave në Para të Gatshme', 'Pasqyrën e Krahasimit të Shumave Buxhetore dhe Aktuale', shënimet shpjeguese dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë, Pasqyrat Vjetore Financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, të pranimeve dhe pagesave, si dhe të buxhetit të realizuar të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime) dhe Rregullën Financiare të Ministrisë së Financave nr. 03/2013 për pasqyrat vjetore financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë e tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa për Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga komuna dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin.

Theksimi i çështjes

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se vlera e pasurive prej 2,468,437,469€ e shpalosur në PVF-të e vitit 2015 nuk është regjistruar në regjistrin kontabël (SIMFK). Kjo ka ndodhur sepse komuna nuk ka arritur t'i regjistrojë në SIMFK pasuritë e identifikuara nga komisioni që ishte formuar në vitin 2012. Ky mos regjistrim në SIMFK shoqërohet me pamundësinë e aplikimit të zhvlerësimit të këtyre pasurive dhe bartjen e saldoshës së pasaktë në vitet e ardhshme;

Bazuar në memorandumet për bashkëfinancim të projekteve, në llogari të donatorëve dhe implementuesve të projekteve ishin kryer pagesa paraprake në vlerë 73,685€ nga buxheti për investime kapitale dhe 214,880€ nga buxheti për mallra dhe shërbime - pa një kontratë, raport të pranimit dhe faturë. Këto pagesa nuk ishin regjistruar si avanse por ishin regjistruar si shpenzime dhe si të tilla ishin raportuar në PVF-të e vitit 2015;

Nga buxheti për investime kapitale komuna kishte paguar mallra dhe shërbime në vlerë 630,856€. Ky mbivlerësim i shpenzimeve për investime kapitale ishte bërë për shkak të buxhetit të kufizuar për mallra dhe shërbime. Vlen të sqarohet se kjo shumë ishte e aprovuar me tabelat buxhetore të Buxhetit 2015 për investime kapitale, por projektet e paraqitura në tabela, nuk përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale, dhe gabimet kanë të bëjnë me planifikimet fillestare nga komuna dhe aprovimet jo adekuate nga ana e Ministria e Financave (MF). Po ashtu, nga buxheti për mallra dhe shërbime komuna kishte financuar një projekt kapital për 'Zgjerimin e ndriçimit publik në qytet dhe fshatra' në vlerë 52,516€, duke mbivlerësuar shpenzimet për mallra dhe shërbime për të njëjtën vlerë;

Vlera e llogarive të arkëtueshmeve e shpalosur në PVF ishte nënvlerësuar për 377,360€; dhe

Pagesat nga palët e treta në vlerë 220,000€ nuk ishin regjistruar në SIMFK dhe nuk ishin raportuar në 'Pasqyrën e Pranimeve dhe të Pagesave në Para të Gatshme' por vetëm ishin shpjeguar në shpalosje.

Opinionin ynë nuk është i kualifikuar në lidhje me këto çështje.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshëm të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për Pasqyrat Vjetore Financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ai ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale, nëse individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Rreziqet domethënëse në PFV

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 26.10.2015, është identifikuar një rrezik domethënës për PVF-të. Ky është rrezik që mund të rezultojë në modifikim të opinionit ose në theksim të çështjes. Rreziku ka të bëjë me regjistrimin e plotë të pasurisë dhe prezantimin e tyre në PVF. Edhe përkundër veprimeve të menaxhmentit, ky rrezik është materializuar sepse aktivitetet e ndërmarra nuk e kanë adresuar plotësisht rrezikun e paraqitur (shih çështjen 33).

1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna duhet të veprojë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Kërkesat e buxhetit;
- Raportet tremujore, përfshirë edhe pasqyrat nëntëmujore;
- Raportet operative (të performancës); dhe
- Nëse draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit është dorëzuar më kohë.

Në Memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 17.12.2015, ne kemi ngritur disa çështje lidhje me kornizën raportuese. Çështjet e ngritura nuk janë adresuar plotësisht nga menaxhmenti i komunës. Si pasojë, në versionin e parë, në PVF-të e dërguara në MF me 31.01.16 ishin të nevojshme disa korrigjime financiare në nenin 12,13,14 dhe 18 që ishin përcjellë me gabime materiale. Përkundër sugjerimeve tona, ne kemi identifikuar si në vijim:

- Neni 12 Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave - nuk janë prezantuar pagesat nga palët e treta në vlerë prej 220,000€ të bashkëfinancimit me IOM, për shkak se nuk ishin regjistruar me kohë në SIMFK, edhe pse janë shpjeguar në shpalosje;
- Keqklasifikimi i kategorive ka shkaktuar mbivlerësimin e investimeve kapitale dhe nënvlerësimin e mallrave në vlerë prej 630,856€ për të cilën komuna nuk ka ofruar shpjegime sqaruese në PVF. Vlen të sqarohet se kjo shumë ishte e aprovuar me tabelat buxhetore të Buxhetit 2015 për investime kapitale;
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime ishin mbivlerësuar për shkak të keqklasifikimit të pagesave për “zgjerimin e ndriçimit publik në qytet dhe fshatra” në vlerë 52,516€;
- Shënimi 31 - vlera e pasurive kapitale është nënvlerësuar për 2,468,437,469€ sepse komuna nuk ka arritur t’i regjistrojë në SIMFK pasuritë e identifikuar nga komisioni që ishte formuar në vitin 2012. Po ashtu dhe pronat e identifikuar gjatë vitit të kaluar ende nuk janë regjistruar (shih çështjen nr. 32).
- Shënim 32 - pasuria kapitale nën 1,000€ është mbivlerësuar për pjesën e shpenzimeve të zhvlerësimit;
- Shënimi 29 - Obligimet janë nënvlerësuar për 1,360€; dhe
- Shënimi 35 - të arkëtueshmet ishin nënvlerësuar për 377,360€.

DEKLARATA E BËRË NGA ZKA DHE ZKF

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, nuk mund të konsiderohet plotësisht e saktë, për shkak se gjatë auditimit janë identifikuar gabime materiale sa i përket palëve të treta, të arkëtueshmeve, pasurisë dhe klasifikimit të shpenzimeve.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, ne kemi vërejtur se komuna nuk përgatit raport vjetor të performancës, që është kërkesë statutoe e komunës.

1.5 Rekomandimet

Rekomandimi 1 Prioritet i lartë - Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për mos adresimin e rrezikut domethënës lidhur me plotësinë e pasurive, si dhe keq-klasifikimin e shpenzimeve dhe pagesat në llogari të donatorëve që ka rezultuar me Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të siguruar një vlerësim të saktë të pasurive kapitale. Ky proces duhet të monitorohet formalisht nga Kryetari i Komunës.

Rekomandimi 2 Prioritet i lartë - Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet, para se në draft PVF të jenë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse dhe janë produkt i një vlerësimi objektiv dhe të pavarur.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim:

- Të fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit, e plotësuar nga komuna edhe pse me vonesë, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e disa aranzhimeve që nuk mbështeten me dëshmi. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi të auditimit të brendshëm të cilësisë së lartë, nuk janë të vendosura.

Rekomandimet

Çështja 1 - Kontraktime të paligjshme - Prioritet i lartë

E gjetura Drejtori i Urbanizmit kishte themeluar një komision për pranim teknik të objekteve të pallatit të drejtësisë dhe kishte nënshkruar kontrata me anëtarët e këtij komisioni prej të cilëve 10 ishin punonjës të komunës ndërsa 5 ishin të jashtëm. Kontraktimi dhe kompensimi i anëtarëve të këtij komisioni nuk ishte në pajtim me ligjin në fuqi. Shpenzimet për këtë komision i kishin kushtuar komunës 106,346€ ku nga kjo shumë 2,377€ ishin shpenzime të përmbarimit. Ky shpenzim ishte bërë sipas Ligjit të vjetër për Ndërtim Nr. 2004/37 ndërsa me Ligjin e ri Nr. 04/L-110, pranimi teknik duhet të bëhet nga inspektorati i komunës. Kjo ka ndodhur për shkak të vonesave në harmonizimin e akteve nënligjore sipas kërkesave të ligjit të ri që ka rezultuar me veprime që nuk kanë pajtueshmëri ligjore. Për më tepër, pagesat për 10 punonjësit e komunës (anëtarë të këtij komisioni) janë në kundërshtim me nenin 80 LMFPP, ku ndalohet kompensimi shtesë për angazhim të stafit në komisione.

Rreziku Mungesa e harmonizimit të akteve nënligjore sipas kërkesave të ligjit të ri ka rezultuar me kontraktime pa bazë ligjore dhe me shpenzime të parregullta për anëtarët e komisionit të pranimit si dhe shpenzime shtesë për procedurat e përmbarimit.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të analizoj rastin e kontratave të nënshkruara në mënyrë të parregullt me stafin e komunës, dhe të merr masat e duhura që rastet e tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

Çështja 2 - Vendimet gjyqësore dhe pagesat direkte nga Thesari - Prioritet i mesëm

E gjetura Thesari kishte ekzekutuar pagesat 525,042€ me vendime gjyqësore dhe 921,73€ në bazë të nenit 39.2 të LMFPP. Për shkak të vonesave në ekzekutimet me kohë të obligimeve, 15 pagesa të testuara kanë rezultuar me pagesën e shpenzimeve shtesë prej 52,005€, (shpenzime të përmbarimit dhe gjykatës 12,629€, dhe shpenzime të interesit 39,376€).

Rreziku Moskryerja me kohë e obligimeve ka pasuar me përballje me gjyqësorin, shpenzim shtesë dhe ulje të reputacionit. Ekzekutimi i pagesave të tilla ndikon në prishjen e ekuilibrit buxhetor dhe rritë rrezikun që projektet e planifikuara me projeksionet fillestare të mos realizohen.

Rekomandimi 4 Për t'iu shmangur situatave të tilla, Kryetari duhet të forcoj kontrollet dhe të siguroj se departamenti i financave posedon të gjitha evidencat mbi detyrimet. Pagesa e detyrimeve të prapa mbetura, duhet të trajtohet me prioritet me rastin e planifikimeve buxhetore, si dhe të forcoj disiplinën financiare dhe të paguaj me kohë të gjitha faturat.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2014 të Komunës së Prishtinës ka rezultuar në 21 rekomandime kryesore. Komuna nuk kishte përgatitur dhe dorëzuar një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si rekomandimet do të adresohen.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, 1 (një) rekomandim është adresuar plotësisht, 10 (dhjetë) janë adresuar pjesërisht dhe 10 (dhjetë) nuk janë adresuar ende. Kjo, në mungesë të Planit të Veprimit dhe neglizhencës së menaxhmentit për adresim të rekomandimeve. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si ato janë adresuar, shihni Shtojcën III.

Çështja 3 - Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura

Vetëm 1 nga 21 rekomandimet e vitit të kaluar është adresuar plotësisht dhe gjysma e rekomandimeve tjera ishin trajtuar vetëm pjesërisht, sepse komuna nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e adresimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. Komuna, gjithashtu, nuk ka zbatuar kërkesën ligjore që ZAP-it t'i dorëzoj Planin e Veprimit brenda 30 ditësh nga dita e publikimit të raportit. Ky plan ishte bashkangjitur si aneks i PVF-ve 2015 por nuk është dorëzuar në ZAP.

Rreziku

Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, si pasojë e mos adresimit të rekomandimeve lidhur me planifikimin, shpenzimet me dhe pa prokurim, inkasimin e të hyrave dhe monitorimin efektiv kanë rezultuar në:

- Dobësi sistematike dhe jo sistematike të prokurimit dhe pagesave;
- Jo efikasiteti i vazhdueshëm organizativ dhe vlerë të dobët për para në praktikën e prokurimit;
- Dobësi në procedurat dhe pagesat e subvencioneve dhe mallrave; dhe
- Dobësi në planifikimin dhe realizmin e të hyrave.

Rekomandimi 5

Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet pse plani i veprimit për vitin e kaluar nuk është dorëzuar në ZAP dhe pse rekomandimet e auditimit nuk janë zbatuar. Ne rekomandojmë që hartimi i planit të veprimit për vitin 2015 të bëhet me kohë dhe të përcaktoj saktë afatet kohore për adresim të rekomandimeve, të përcaktoj stafin përgjegjës, me fokus fillestar në çështjet më të rëndësishme të ngritura nga auditimi.

2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetëvlerësimit të MFK-së (Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli) të dorëzuara në MF, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Më poshtë, ne kemi përmbledhur gjetjet tona për komunën, të cilat nuk kanë për qëllim dhënien e komenteve për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit, por të paraqet gjendjen në një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Rekomandimi

Çështja 4 - Lista kontrolluese e vetëvlerësimit - Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, ne kemi shqyrtuar gjashtë çështje kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me pesë komponente. Komuna kishte përgatit dhe dorëzuar me vonesë pyetësorin në MF. Nga çështjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

- Komuna posedon Planin e Zhvillimit Komunal të trashëguar nga 2013. Ky plan i hartuar nga qeverisja e kaluar nuk ishte i azhurnuar, nuk përfshinte një kosto për implementim dhe nuk ka dëshmi mbi pjesëmarrjen e palëve të interesit në përpilimin e kësaj strategjie.
- Proceset e monitorimit konsiderohen si të vendosura nga komuna, edhe pse dëshmitë në mbështetje të këtyre konkluzioneve janë të pa qëndrueshme. Ky aspekt është shqyrtuar më hollësisht në nënkapitullin 2.5.2; dhe
- Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1.

Auditimi i Brendshëm nuk i ka theksuar çështjet më lart. Për më shumë, veprimi i ndërmarre për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vetëvlerësimi i vitit 2015 është i limituar. Kjo, për shkak të mungesës së qartësisë brenda komunës që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

Rreziku Mungesa e një strategjie gjithëpërfshirëse e minimizon efektin e proceseve operative dhe pamundëson matjen e realizimit të objektivave kundrejt rezultateve. Aranzhimet e dobëta të qeverisjes i dobësojnë proceset operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë permanente. Auditimi i brendshëm duhet të aplikoj një proces rishikimi për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin ku operon komuna dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në procedurën e MFK-së Nr.4 - Menaxhimi i rrezikut kërkon që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

Rekomandimi

Çështja 5 - Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut - Prioritet i lartë

E gjetura Pyetëtori i vetëvlerësimit të plotësuar nga komuna ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut nuk ishin ende funksionale. Komuna nuk kishte vendosur një sistem formal të menaxhimit të rrezikut duke identifikuar, vlerësuar, reaguar, kontrolluar dhe marr masa për parandalim ose reduktim të rreziqeve në nivel të arsyeshëm. Edhe pse ekziston një plan për integritet 2014-2016, aktivitetet që parashihen me këtë plan ishin të mangëta për arsyen se ende nuk janë ndërmarr hapa të mirëfilltë dhe përgjegjësia për zhvillimin e mëtutjeshëm të menaxhimit të rrezikut, ende ka nevojë për përmirësim.

Rreziku Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve pasi çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë, nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e rreziqeve nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.

Rekomandimi 7 Kryetari duhet të sigurojë se në bashkëpunim me ekipin e tij menaxhues do të diskutoj dhe identifikoj rreziqet e nivelit të lartë në të gjithë sektorët e komunës, të përcaktoj masat dhe veprimet parandaluese, si dhe të delegoj përgjegjësitë për menaxhimin e rrezikut te stafi përkatës. Gjithashtu, duhet të sigurojë raportime dhe shqyrtime të rregullta për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

2.5.2 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti i komunës duhet të zbatojë një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj sfidave operative dhe financiare të identifikuara.

Rekomandimi

Çështja 6 - Dobësi në kontrollet menaxheriale - Prioritet i lartë

E gjetura Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës, ka nxjerrë në pah një raportim jo adekuat financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Situatë e ngjashme ekziston edhe lidhur me raportimet në nivel të drejtorive komunale, përkundër që deklarohet për një raportim mujor. Ngjashëm, synimet operacionale nuk menaxhohen në mënyrë sistematike. Mungesa e raporteve të rregullta në nivelin e drejtorëve, bordit, për kuvendin, raporti mbi ekzekutimin e projekteve, raporti për bashkëfinancim me organizatat tjera buxhetore dhe donatorë nxjerrë në pah dobësitë për një raportim cilësor.

Rreziku Cilësia e raportimit financiar dhe të aktiviteteve operative tek menaxhmenti i lartë dhe drejtorët komunal, redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e komunës në mënyrë efikase si dhe ulë efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo mund të rezultojë në deficit ose suficit të paplanifikuar dhe të vonojë veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato. Kjo gjithashtu mund të bëjë që të hyrat të mos arkëtohen në nivelin e pritur. Ngjashëm, mund të rezultojë në ofrimin e shërbimeve të dobëta.

Rekomandimi 8 Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2016.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me 4 anëtarë të stafit/auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të komunës dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

NjAB nuk kishte arritur të përmbushë planin, duke përfunduar 5 raporte ndaj 11, sa kishte planifikuar. Kryesisht raportet e NJAB janë fokusuar në vitin paraprak (3 prej tyre) dhe vërehet mos interesim i menaxhmentit për adresimin e rekomandimeve. Komiteti i Auditimit (KA) kishte pushuar aktivitetet e veta si shkak i kalimit të njërit anëtar - si zyrtar i NAJB, dhe largimit të kryetarit të këtij komiteti. Për më tepër, ende ekziston një komunikim i dobët midis NJAB dhe menaxhmentit si pasojë e largimit me komision disiplinor të drejtorit të NJAB për një periudhë të gjatë kohore. NjAB edhe gjatë vitit 2016, sa ne ishim në auditim, nuk kishte zhvilluar asnjë aktivitet në mungesë të miratimit të planit të auditimit për këtë vit.

Rekomandimi

Çështja 7 - Dobësi në auditimin e brendshëm - Prioritet i lartë

- E gjetura** Ekzistojnë disa dobësi në lidhje me operacionet aktuale të NJAB:
- Mungesa e një trajtimi dhe komunikimi adekuat ka prodhuar aktivitet dhe cilësi të dobët të auditimit të brendshëm. Auditimet e kryera nuk kanë pasur ndonjë fokus në vitin aktual dhe në aspektet e qeverisjes për të parandaluar gabimet. Për më tepër, kjo njësi nga themelimi e deri me tani nuk kishte përpiluar statusin për NJAB dhe KA; dhe
 - Menaxhmenti nuk kishte formuar Komitetin e Auditimit i cili është një rregullator i punës, cilësisë dhe aktiviteteve të NjAB.
- Rreziku** Si rezultat i gjetjeve më lartë, konkluzioni ynë është se menaxhmenti nuk i kushton ndonjë rëndësi shërbimeve të auditimit të brendshëm. Kjo rritë rrezikun që kontrollet e brendshme të vendosura nga menaxhmenti të mos operojnë në mënyrë efektive dhe dobësitë e sistemeve të mos identifikohen.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet të sigurojë se funksioni i auditimit të brendshëm do të fuqizohet dhe materializohet me trajtimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe ofrimin e sigurisë së arsyeshme se kontrollet operojnë në mënyrë efektive dhe ashtu siç janë dizajnuar. Në funksion të maksimizimit të përfitimeve nga auditimi i brendshëm, ne sugjerojmë edhe themelimin e Komitetit të Auditimit brenda një afati të arsyeshëm.
-

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për MFK jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Në fushën e MFK, prokurimi mbetet fusha ku janë identifikuar dobësi të shumta, dhe si rezultat i mos zbatimit të rregullave, nuk është e sigurt nëse është arritur vlera për para. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar komunën që mos të pësojë realizim të ulët të buxhetit për investime kapitale, më pak projekte për qytetarët dhe rritje të borxheve.

Gjithashtu, kontrollet mbi të hyrat, në përgjithësi nuk janë edhe aq të përshtatshme dhe nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, sidomos tek mbledhja e të hyrave, e që kanë rezultuar me rritje të llogarive të arkëtueshme. Fushat tjera ku nevojiten kontrolle të shtuara, janë shpenzimet për mallra dhe subvencionet.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për Komunën e Prishtinës, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final ¹ | 2015 Realizimi | 2014 Realizimi | 2013 Realizimi |
|---|-------------------|----------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Burimet e Fondeve: | 55,872,234 | 81,335,971 | 64,525,481 | 56,801,207 | 68,692,532 |
| Granti i Qeverisë - Buxheti | 31,553,984 | 35,707,031 | 35,573,654 | 40,116,243 | 40,018,302 |
| Të bartura nga viti paraprak ² | | 17,893,989 | 16,383,352 | 5,903,886 | 16,563,303 |
| Të Hyrat Vetjake ³ | 24,318,250 | 27,162,609 | 12,265,988 | 10,718,580 | 11,909,318 |
| Donacionet e brendshme | | 17,015 | 4,700 | 4,800 | 14,079 |
| Donacionet e jashtme | | 555,327 | 297,787 | 57,698 | 187,530 |

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 25,463,737€. Kjo rritje prej 46% ishte rezultat i mos aprovimit me kohë të buxhetit në Kuvendin Komunal, i cili kishte buxhetin fillestar të njëjtë me vitin e kaluar, dhe tek me 24.02.15 ishte miratuar buxheti në vlerë prej 62,706,756€. Rritja buxhetore është rezultat i donacioneve brendshme dhe të jashtme 572,342€, të hyrave të bartura nga viti paraprak 17,893,989€ dhe ndryshimit të planit për rritjen e inkasimit të hyrave vetjake 2,844,359€. Ndërsa, granti qeveritar është rritur për 4,153,047€.

Në vitin 2015, komuna ka ekzekutuar 79% të buxhet final ose 64,525,481€, me një përmirësim prej 10% krahasuar me vitin 2014 (69%). Realizimi i buxhetit është në nivel të ultë dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2015 Realizimi | 2014 Realizimi | 2013 Realizimi |
|---|-------------------|-------------------|-------------------|------------------|-------------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike: | 55,872,234 | 81,335,971 | 64,525,481 | 5,801,207 | 68,692,532 |
| Pagat dhe Mëditjet | 21,671,577 | 27,407,524 | 27,404,645 | 25,610,137 | 22,165,668 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 9,255,582 | 9,757,727 | 9,008,155 | 7,872,882 | 7,434,683 |
| Shërbimet komunale | 1,760,431 | 2,093,000 | 2,079,910 | 1,609,849 | 1,551,636 |
| Subvencionet dhe Transferet | 1,595,000 | 2,783,357 | 1,621,155 | 4,791,642 | 2,591,286 |
| Investimet Kapitale | 21,589,644 | 39,294,362 | 24,411,616 | 16,916,697 | 34,949,259 |

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Pavarësisht buxhetit në dispozicion të komunës për investime kapitale, gjatë vitit vetëm 62% e buxhetit për këtë kategori ishte shpenzuar, edhe pse krahasuar me vitin paraprak komuna ka treguar performancë më të larët të shpenzimit të këtyre fondeve për 17%. Buxheti final në krahasim me buxhetin fillestar ishte rrit për 17,704,718€;
- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje është për 5,735,947€. Lëvizja buxhetore për këtë kategori ka ndodh si pasojë e rritjes nga të hyrat e bartura prej 162,049€ dhe të ngritjes së grantit qeveritar për 5,312,638€, donacioneve të jashtë prej 5,732€, mbulimit të deficitit buxhetor nga grandit qeveritar për 755,484€ dhe zvogëlimit për 500,000€ nga të hyrat e planifikuara të 2015;
- Rritja e buxhetit final për mallra dhe shërbime ishte 502,145€ apo 5%;
- Rritja e buxhetit për komunalitë prej 332,569€ është rezultat i të hyrave të bartura për 300,000€ dhe ngritjes së grantit qeveritar për 32,569€;
- Pavarësisht buxhetit në dispozicion të komunës për subvencione dhe transfere gjatë vitit, 58% e buxhetit për këtë kategori ishte shpenzuar edhe pse krahasuar me vitin paraprak komuna ka treguar performancë më të dobët për 27% të shpenzimit të këtyre fondeve (85% sa ishte në vitin e kaluar si pasojë e subvencionimit për ngrohje me kogjenerim). Rritja e buxhetit për 1,188,357€ për subvencione dhe transfere ishte si rezultat i bartjes së të hyrave nga viti paraprak për 573,357€ dhe ngritjes së buxhetit prej të hyrave të këtij viti për 615,000€;
- Suficiti domethënës i fund vitit prej 14,882,746€ kundrejt buxhetit në kategorinë e Investimeve kapitale është për shkak të planifikimit jo adekuat të hyrave vetjake të cilat nuk janë realizuar dhe realizimit të vonuar të projekteve. Pavarësisht kësaj, niveli i detyrimeve të papaguara vazhdon të jetë i lartë (1,142,513€), që është gati në nivelin e njëjtë me vitin e kaluar (1,192,224€); dhe
- Komuna ka pasur në dispozicion grante nga donatorët në vlerën 572,341€ prej të cilave 216,855€ janë pranuar gjatë vitit aktual. Realizimi i buxhetit prej 302,487€ apo 53% nga këto burime, nuk është i kënaqshëm dhe fondet e mbetura ishin 269,854€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e komunës – ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2015 Pranimet | 2014 Pranimet | 2013 Pranimet |
|---|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Gjithsej të hyrat vetjake | 24,318,250 | 27,162,609 | 18,035,992 | 19,904,415 | 21,748,614 |
| Shërbimet administrative, tarifaf dhe ngarkesat tjera | 24,318,250 | 27,162,609 | 17,273,228 | 18,395,679 | 21,191,029 |
| Dënimet e policisë | | | 375,688 | 869,753 | 236,008 |
| Gjobat e gjykatave | | | 380,260 | 634,240 | 314,769 |
| Të hyrat nga ekonomia e pyjeve | | | 6,816 | 4,744 | 6,809 |

Nuk është e qartë qasja ndaj planifikimit fillestar të hyrave. Nga tabela shihet se pranimet gjatë vitit 2014 ishin 19,904,415€, ndërkaq shuma e planifikuar për 2015 ishte 24,318,250€. Komuna nuk kishte bërë analizat e duhura dhe krahasimin e trendit të të hyrave gjatë viteve. Si rezultat i analizave të mangëta dhe planifikimit të dobët, inkasimet gjatë vitit 2015 ishin 18,035,992€ apo 66% e buxhetit final. Mos konsistencat në planifikimin dhe realizim të hyrave, ndikojnë direkt në planifikimin e projekteve potenciale për t'u financuar nga burimet vetjake.

Rekomandimet

Çështja 8 – Ekzekutimi i ulët i buxhetit për kapitale dhe subvencione – Prioritet i lartë

E gjetura Ekzekutimi i buxhetit në investime kapitale dhe subvencione nuk ishte në nivelin e pritur, ndërkohë që një pjesë e suficitit ishte jashtë kontrollit të komunës, shpenzimet e tjera kanë mundur të bëhen në fund të vitit. Kjo ka ndodhur për shkak që komuna kishte planifikuar shuma që nuk ishin inkasuar sipas parashikimeve.

Rreziku Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimit i ulët i tij, do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore rishikohet në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivele të planifikuara. Këtij aktiviteti duhet t'i paraprijë një proces i mirëfilltë i planifikimit, përcaktimit të objektivave dhe ndërlidhjes së tyre me buxhetin e komunës.

Çështja 9 - Mosefikasitet në inkasimin e të hyrave vetjake - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna kishte realizuar vetëm 18,035,992€ të hyra apo 66% nga planifikimi prej 27,162,609€. Krahasuar me vitet e mëparshme komuna është përballur me një trend në ulje në realizimin e të hyrave për 9% me pak për 2014, dhe 17% me pak se viti 2013.

Rreziku Realizimi i ulët i të hyrave krahasuar me planifikimin rrezikon ngecjen në realizimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetjake dhe mos përmbushjen e objektivave të organizatës.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të analizoj arsyet e mos realizimit të hyrave dhe trendin e të hyrave gjatë viteve të fundit dhe në bazë të kësaj të bëjë një planifikim objektiv dhe të realizueshëm. Më tej, i njëjti plan duhet të pasohet me aktivitete dhe masa adekuate për zbatim.

Çështja 10 - Klasifikimi i gabuar i shpenzimeve kapitale - Prioritet i mesëm

E gjetura Komuna ka bërë 14 pagesa prej 630,856€ nga buxheti i kategorisë së investimeve kapitale për mallra dhe shërbime dhe një pagesë 52,516€ nga mallrat për kapitale. Këto shpenzime ishin raportuar si investime kapitale apo anasjelltas. Këto keqklasifikime kryesisht kishin ndodhur për shkak të buxhetit të kufizuar për mallra dhe shërbime. Shpenzimet si të tilla ishin aprovuar me Ligjin e Buxhetit, përderisa komuna në PVF nuk kishte bërë shpalesje sqaruese për këto shpenzime.

- Në katër raste pagesat 441,843€ për mirëmbajtje dhe zgjerimin e sipërfaqeve gjelbëruara, ishin paguar dhe kategorizuar si mirëmbajtje investive, ndërkaq duhej të trajtoheshin si shërbime të mirëmbajtjes së rregullt;
- Në tri raste pagesa 37,849€ për “vaksinimin e gjedheve” dhe “trajtimin dhe vaksinimin qenve” ishin paguar dhe kategorizuar si kapitale, ndërkaq që duhej të kategorizoheshin si mallra dhe shërbime;
- Në dy raste pagesa 30,110€ për blerjen e mobileve dhe pajisjeve nën 1,000€ ishin paguar dhe kategorizuar si kapitale duke nënvlerësuar mallrat dhe shërbimet;
- Dy pagesa prej 27,294€ për hartimin e projekteve si shërbime janë paguar dhe kategorizuar si kapitale. Këto shpenzime i takojnë kategorisë së shërbimeve.
- Pagesa prej 9,724€ për organizimin e edicionit 15 të festivalit ‘Ylberi i Prishtinës’, ishte kategorizuar dhe paguar nga kapitalet edhe pse i takojnë kategorisë së Shërbimeve tjera kontraktuese.

- PAGESA prej 9,336€ për hartimin e elaborateve gjeomekanike, është paguar nga kapitalet edhe pse i takon kategorisë së shërbimeve.
- PAGESA prej 74,700€ për deratizimin e kanalizimeve dhe dezinfektimin e hapësirave publike, ishte paguar dhe kategorizuar si kapitale, ndërsa i takon natyrës së shërbimeve të mirëmbajtjes.
- PAGESA për 52,516€ për “zgjerimin e ndriçimit publik në qytet dhe fshatra” ishte kategorizuar dhe paguar nga mallrat, edhe pse i takon kapitaleve.

Rreziku Përdorimi i fondeve në kundërshtim me ligjin për ndarjet buxhetore, rezulton me reduktim të fondeve për investime, dhe mungesa e një shpalosje adekuate ulë transparencën e organizatës në prezantimin e drejt të informatave për shfrytëzuesit.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të siguroj se përdorimi i fondeve të bëhet në përputhje me ndarjet fillestare të buxhetit, dhe në rast të devijimeve të tilla, shpenzimet duhet të prezantohen dhe shpalosen në përputhje me kërkesat ligjore duke ofruar një transparencë të plotë për përdoruesit e pasqyrave financiare.

3.4 Prokurimi

Shpenzimet përmes prokurimit ishin bërë kryesisht për mallra dhe shërbime dhe investime kapitale. Rregullat e prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulë rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit e tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Rekomandimet

Çështja 11 - Furnizimet e pa pranuar - Prioriteti i Mesëm

E gjetura Komuna kishte bërë pagesën e situacionit në vlerë 80,703€, për “Rekonstruimin dhe gëlqerosjen e shkollave” ku është përfshirë edhe pozicioni për furnizimin dhe montimin e skelave prej 20,525€, i cili nuk përputhej me objektiven e kësaj kontrate pune (pozicioni është i përfshirë në kontratë për vetëm 1,000€ por nuk ka qëllim furnizimin me mallra/skele). Komuna edhe pse ka paguar këtë vlerë nuk është furnizuar me mjete/skele, por ka kontraktuar punë me OE i cila duhet t’i posedonte këto mjete me rastin e tenderimit si kushte për kryerje të punëve.

Rreziku Kontrollat e prokurimit kanë dështuar në përgatitjen e dosjes së tenderit, dhe si rezultat janë kryer punë të cilat nuk përputhen me objektivin e kontratës. Së këndejmi, këto konsiderohen si pagesa të parregullta të cilat mund ti shkaktojnë komunës dëme buxhetore.

Rekomandimi 13 Kryetari të analizoj pse në rastin më sipër nuk janë zbatuar kërkesat e prokurimit dhe nga departamentet përkatëse të siguroj kontrole efektive që me rastin e hartimit të kërkesës, specifikimit, paramasës dhe parallogarisë, të përcaktohen saktë të gjitha pozicionet e punëve apo shërbimeve, me qëllim të evitimit të pagesave të parregullta.

Çështja 12 - Inicimi i prokurimi për punë pa projekte - Prioritet i lartë

E gjetura Në 3 raste, “Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në lagjen Përroi i Njelmët”, “Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit për lagjen Arbëria” dhe “Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit për lagjen Arbëria dhe Qemal Stafa”, komuna ka filluar procedurat e prokurimit pa plan detal të ndërtimit, në kundërshtim me nenin 4 të UA 01/2014 të KRPP, që përcakton se AK përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutiv cili në mënyrë mandatore duhet t’i bashkangjitet specifikacionit teknik të dosjes së tenderit.

Rreziku Mos hartimi i projektit zbatues rrezikon që gjatë realizimit të projekteve kapitale të pranojmë cilësi të dobët të punëve, vlerë të ulët për para, shkelje të standardeve për ndërtim në përsëritje të punëve dhe punë shtesë të pa parapara.

Rekomandimi 14 Kryetarin të siguroje se shërbimi i prokurimit do të zbatohet në mënyrë strikte kërkesën që para fillimit të secilës procedurë të prokurimit për punë/ndërtim është bërë hartimi i projektit ekzekutiv të ndërtimit.

Çështja 13 - Kontraktim i dyfishtë i punëve - Prioritet i lartë

E gjetura Në dy raste për “Ndërtimin e rrugës Koliq - Keqekollë”- 245,166€, dhe “Ndërtimin e bulevardit mbi kurriz”- 977,726€, komuna kishte lidhur kontratë ku ishte përfshirë edhe pozicioni për hartimin e projektit pas ekzekutimit. Në këtë mënyrë ishte bërë kontraktim të dyfishtë për këtë shërbim, pasi që komuna kishte bërë hartimin e këtyre projekteve para fillimit të procedurës së ekzekutimit. Komuna ka bërë pagesën sipas këtij pozicioni për rrugën Koliq - Keqekollë në vlerë 1,233€ duke shkaktuar shpenzim të dyfishtë, ndërsa kontrata për projektin tjetër ende nuk është finalizuar.

Rreziku Kontraktimi shërbimeve për pozicione të kryera rezulton me pagesa të dyfishta për të njëjtin shërbim, duke shkaktuar shpenzime të parregullta të parasë publike dhe dëmtim të buxhetit komunal.

Rekomandimi 15 Kryetari të siguroj që me rastin e hartimit të planeve detale për projekte, të bëhet rishikimi rigoroz i tyre në mënyrë që të mos ketë ndryshime gjatë ekzekutimit dhe të mos bëhen shpenzime të dyfishta për të njëjtin shërbim.

Çështja 14 - Mosrespektimi i procedurave të prokurimit - Prioritet i lartë

E gjetura Zhvillimi i procedurave të prokurimit ishte përcjellë me dobësi si në vijim:

- Në dy raste “Ndërtimin i rrugëve në Prugovc” dhe “Furnizim me qumësht për punëtoret e komunës”, periudha e mbulueshmërisë së sigurimit të ekzekutimit ishte më e shkurtër se sa kërkesa e përcaktuar në dosjen e tenderit; dhe
- Ne pesë raste komuna nuk kishte arritur të vendos parallogaritë për shërbimet. Për më tepër, katër nga këto procedura nuk kishin të bashkangjitur planin për menaxhim të kontratës.

Rreziku Mangësitë e identifikuar rezultojnë me respektim të pjesshëm të procedurave të përcaktuara me Ligjin e Prokurimit Publik (LPP) dhe kontrole të dobëta në inicimin, menaxhimin dhe ekzekutimin e projekteve.

Rekomandimi 16 Kryetari të siguroj se zhvillimi i procedurave të prokurimit do t’u nënshtrohet kontroleve rigoroze që nga inicimi i procesit deri tek implementimi i kontratave.

Çështja 15 - Dobësi në pagesat për mallra dhe shërbime - Prioritet i lartë

E gjetura

Pagesat për mallra dhe shërbime ishin përcjellë me dobësi si në vijim:

- Ne dy raste, pagesa në vlerë 250,039€ dhe pagesa direkte nga thesari sipas nenit 39.2 në vlerë 266,447€ për “shërbimin e rrënimt” ishte bërë bazuar në një aneks kontratë kornizë në kundërshtim me LPP neni 38.2. Asnjë kontratë publike kornizë nuk duhet të këtë kohëzgjatje më shumë se 36 muaj. Për më tepër, menaxheri i kësaj kontrate kishte pranuar edhe punë jashtë kontrate. Njëherit, në bazë të dëshmive, kalkulimi për pagesë nuk ishte bërë në baza reale duke shfrytëzuar çmimet më të larta të ofertës dhe shërbimet e pa kontraktuara, si pasojë e menaxhimit jo adekuat të ekzekutimit të kontratës;
- Komuna ka hyrë në marrëveshje mirëkuptimi me “Trafikun urban” nga 03.12.2014 me qëllim të bartjes e pensionistëve dhe stafit komunal nga banimi i tyre deri te ndërtesa e re e komunës, duke bërë pagesë në llogarinë e përfituesit nga 5,000€ për muaj, pa kontratë valide. Shpenzimi vjetor prej 60,000€ për këtë shërbim nuk ka bazë të qartë ligjore. Stafi i komunës duhet të jetë në vendin e punës në orarin e përcaktuar nga punëdhënësi;
- Kontrata kornizë e datës 19.05.2014 ishte lidhur për pastrimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shëndetësore të kujdesit primar në vlerën mujore 19,496€. Kjo kontratë ishte aneksuar për dy objekte të reja të cilat ishin aktivizuar në qershor në vlerë prej 1,410€. Nënshkrimi i këtij aneksi nuk parashihet me LPP-në;
- Për muajin dhjetor, pagesa 65,628€ për naftë për ngrohje për nevoja të Qendrave të Mjekësisë Familjare (QMF) ishte kodifikuar gabimisht si shërbim i kontraktuar, jo si shpenzim i naftës për ngrohje. Sipas të njëjtës kontratë, ishte parashikuar furnizim me sasi prej 30,000 litra, ndërsa për tre mujorin e parë, komuna kishte furnizuar shkollat me naftë përafërsisht 400 mijë litra;
- Në dy raste për vonesë të furnizimit me “Uniforma për zjarrfikësit” dhe “Furnizim me tepisona për shkolla”, komuna nuk kishte aplikuar gjobat sipas kontratës për vonesat në ekzekutim 0.25% vonesa ditore deri në 10% të vlerës apo të tërheqë garancionin për realizim;
- Një pagesë prej 11,283€ për sigurimin fizik të objekteve QMF për muajin janar ishte bërë duke shfrytëzuar një kontratë kornizë që nuk kishte përfshirë edhe sigurimin për këto objekte. Kjo ka ndodhur për shkak të nevojave të komunës përballë zgjatjes së procedurës për lidhje të kontratës si pasojë e procedurës ankimore. Për më tepër, pagesa është bërë nga kodi shërbime kontraktuese tjera, jo nga kodi ekonomik sigurim i objekteve;

- Në katër raste QKMF-ja kishte zhvilluar aktivitete të prokurimit të cilat nuk ishin përfshirë në raportin e realizimit të prokurimit dhe komuna nuk kishte informatë mbi autorizimin e kësaj njësie për zhvillimin e procedurave të prokurimit. Për më tepër, në dy raste kontratat e kuotimit për “Ditën e QKMF” dhe “Organizimin e seminarit për shëndetësinë në Shqipëri “ ishte lidhë sipas çmimit për njësi me çmime jo fikse, pa përcaktuar numrin e pjesëmarrësve;
- “Organizimi i ditës së fëmijëve 1 qershor” pjesa teknike sipas raportit të pranimit nuk ishte përmbushur për shkak se operatori nuk kishte ofruar artikujt sipas kontratës, sigurimin fizik dhe zërimin, ndërsa ishte paguar në tërësi 9,900€; dhe
- Paga 9,708€ si shërbime kontraktuale për “Mirëmbajtje të semaforëve” ishte paguar edhe pozicioni për kontrollin e 13 nyjeve semaforike (5,430€) i kontraktuar si pozicion i cili nuk ka mund të monitorohet nga komuna. Për më tepër, komuna ka një qendër të vëzhgimit të semaforëve dhe në mënyrë elektronike kompania pranon mesazh për mosfunksionimin e semaforëve në qytet.

Rreziku

Anashkalimi i rregullave të prokurimit publik ka rezultuar me dobësi në ekzekutimin e kontratave. Komuna rrezikon të hyjë në obligime pa mbulesë për shkak të menaxhimit jo efektiv të kontratave dhe të përballet me padi, të cilat mund të rezultojnë me shpenzime shtesë për buxhetin e komunës.

Rekomandimi 17 Kryetari duhet të siguroj masat e duhura për respektimin e rregullave të prokurimit publik dhe të ushtroj mbikëqyrje të përshtatshme për menaxhim cilësor të kontratave.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

3.5.1 Avanset, komunalitë dhe pagesat në llogari të donatorëve

Në shpenzimet që nuk kërkojnë procedura të prokurimit bëjnë pjesë: pagat, komunalitë, shpenzimet që paguhen me para të imëta, subvencionet dhe transferet, avanset për udhëtime zyrtare etj. Pa procedura të prokurimit, komuna ka bërë edhe disa shpenzime në bazë të marrëveshjeve të bashkëfinancimit.

Rekomandimet

Çështja 16 – Pagesat për projektet e bashkëfinancuara – Prioritet i lartë

E gjetura

Komuna kishte nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi për bashkëfinancim të disa projekteve. Në të gjitha rastet e identifikuara komuna kishte transferuar mjetet në llogarinë e bashkëfinancuesve, bazuar vetëm në këto marrëveshje. Për më tepër, transferi i mjeteve ishte regjistruar si shpenzim, pa raport të pranimit dhe faturë që do të konfirmonte kundërvlerën për shpenzime. Rastet e identifikuara kanë të bëjnë me marrëveshjet si vijon;

- Sipas marrëveshjes së mirëkuptimit ndërmjet komunës, Unionit Evropian si financues dhe Gratë në Biznes (GnB) dhe Qendrës Ekzekutive për Ndërmarrësi dhe Zhvillim (CEED) si implementuese të projektit për ngritjen e 'tregut mobil të fermerëve për Prishtinën', komuna kishte paguar 21,918€ nga investimet kapitale dhe 127,178€ nga mallrat dhe shërbimet në llogarinë e CEED-së, ndërsa 31,794€ nga investimet kapitale dhe 87,674€ nga mallrat dhe shërbimet në llogari të GnB. Në vitin 2016 implementuesit e projekteve kishin raportuar në komunë për mënyrën dhe shumën e shpenzuar deri më 30 maj 2016. Sipas raporteve të vitit 2016, për këtë projekt janë shpenzuar 223,715€ ndërsa pjesa tjetër në vlerë 44,849€ do të shpenzohet në periudhën pasuese. Raportet e dorëzuara nuk ofrojnë një bazë të plotë për komunën për t'u siguruar për mënyrën e shpenzimit të fondeve; dhe
- Sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe HELP – HILFE për mbështetje, stabilitet socio-ekonomik përmes fuqizimit të sektorit të mikrobiznesit në Kosovë, komuna nga kategoria investime kapitale kishte bërë pagesën në llogarinë e përfituesit HELP në vlerë prej 19,972€. Në vitin 2016 komuna kishte pranuar një raport lidhur me aktivitetet dhe progresin e projektit por ky raport nuk specifikon koston/vlerën e realizimit të projektit.

Rreziku Pagesat bazuar vetëm në marrëveshje mirëkuptimi apo bashkëpunimi, nuk kanë bazë të qartë juridike për realizim të shpenzimeve, pasi që rregullat financiare nuk njohin një formë të tillë të shpenzimeve. Duke qenë se komuna nuk posedon mekanizma garantues se marrëveshjet do të realizohen siç janë përcaktuar, ekziston rreziku real që marrëveshjet të mos realizohen, objektivat të mos arrihen, dhe fondet e shpenzuara të mos kthehen. Në mungesë të mbikëqyrjes nga komuna, nuk është e qartë nëse projektet janë kryer me cilësinë e duhur dhe nëse është fituar vlera për paranë.

Rekomandimi 18 Kryetari duhet të sigurojë që kjo praktikë të mos përsëritet me rastin e marrëveshjeve të reja, ndërsa për marrëveshjet në implementim e sipër, të forcohen kontrollet, sidomos në kërkesën e raporteve periodike nga partnerët për progresin e arritur kundrejt fondeve të shpenzuara. Në aranzhimet vijuese, për të gjitha projektet e ngjashme, komuna duhet të merr rolin e autoritetit kontraktues, dhe t'i udhëheq vet të gjitha procedurat që nga inicimi deri në përfundimin e projekteve. Komuna duhet të përgatit raportet përfundimtare për realizimin e projekteve të financuara deri tani, dhe në auditimin e radhës, ato do të jenë pjesë e veçantë e rishikimeve.

Çështja 17 - Parregullsi në shpenzimet pa prokurim – Prioritet i lartë

E gjetura Ne kemi identifikuar disa shpenzime që janë përcjellë me dobësitë si në vijim:

- PAGESA sipas faturës 5,679€ për 29 bileta të aeroplanit për udhëtimin në Stamboll, të personelit të Qendrës së fëmijëve, ishte bërë sipas kërkesës jo formale fillestare për 30 pjesëmarrës në vlerë 3,270€ (2,409€ më e ulët se sa shpenzimi faktik). Gjithashtu, në dosje mungonte kërkesa standarde dhe aprovimi zyrtar, dëshmitë për arsyetimin e udhëtimit si kopje e biletave, pasaportave, lista e pjesëmarrësve, etj;
- Në dy raste, pagesa 429€ shpenzime të hotelit dhe 305€ për bileta udhëtimi në Zagreb, nuk kishin një kërkesë të aprovuar paraprakisht, por vetëm një shkresë të nënshkruar një muaj më vonë si mbulesë udhëtimi. Shpenzimi nuk është në përputhje me UA 2004/07;
- PAGESA për dy anëtarë në vlerë 550€, për takimet e këshillit drejtues të teatrit Dodona, e bërë sipas një vendimi është e pa rregullt; dhe
- PAGESA për drekë zyrtare 1,000€ me rastin e konferencës përmbyllëse të një vjetorit të qeverisjes, kishte të bashkangjitur vetëm një shkresë të nënshkruar për arsyetim të shpenzimit, dhe nuk ka dëshmi për pjesëmarrësit.

Rreziku Dështimi në zbatimin e procedurave të duhura të pagesave dhe udhëzimeve shoqëruese, mund të rezultoj me pagesa potencialisht të parregullta dhe humbje financiare për komunën.

Rekomandimi 19 Kryetari duhet të përcaktojë se pse pagesat nuk ka qenë subjekt i kontrolleve të duhura në përputhje me kërkesat ligjore, dhe duhet t'i forcoj kontrollet për të siguruar që veprimet e tilla të evitohen.

3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollet që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: kontrollin e pagesave, duke i nënshkruar listat e pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve; dhe rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Rekomandimet

Çështja 18 - Kontratat për shërbime të veçanta - Prioritet i lartë

E gjetura Rishikimi ynë i angazhimit të punëtorëve me kontratë për shërbime të veçanta ka identifikuar këto dobësi:

- Gjatë këtij viti ishin angazhuar 276 zyrtarë (siguruar nga regjistri i furnitorëve) të cilët janë paguar në vlerë prej 463,849€, me kontrata për shërbime të veçanta. Prej tyre, 31 janë angazhuar në një projekt në mes komunës dhe HELVETAS dhe 53 punojnë në kuzhina dhe shërbim të ushqimit për institucionet parashkollore, kurse pjesa tjetër prej 192 është e angazhuar në programet e përhershme të punës si ofiqarë, inspektorë, zyrtarë të lartë, regjistruar, anketues etj. pa ndonjë procedurë të rekrutimit apo prokurimit. Punësimi i tyre është bërë në kundërshtim me nenin 31 dhe 35 të Rregullores për shpenzimin e parasë publike 01/2013, pasi që nuk ka dëshmi se komuna ka plotësuar formularin i cili specifikon se është zhvilluar testi i marrëdhënies së punës dhe dëshmi mbi përzgjedhjen e tyre sipas procedurave të zakonshme të prokurimit. Gjithashtu, dosjeve iu mungojnë dëshmitë për pagesën e obligimit ndaj ATK-së, deri në fund të vitit, kur komuna ka filluar këtë obligim ta proceson direkt në llogarinë e ATK-së;
- Në katër raste kontratat ishin nënshkruar pasi që punëtorët kishin filluar punën, dhe 18 raste tjera, angazhimi i tyre ka vazhduar me tepër se 6 muaj; dhe
- Në nëntë raste nga shërbimet kontraktuale, ishin paguar shërbyes civil të komunës për angazhimin në projekte të ndryshme të ekzekutuar nga komuna në vlerë 1,500€ në kundërshtim me nenin 80 të LMFPF,.

Rreziku Mbulimi i pozitave të rëndësishme me marrëveshje të përkohshme rezulton me performancë dhe monitorim të dobët të stafit dhe rritë pasigurinë nëse në pozitat e tilla është angazhuar stafi adekuat. Së këndejmi, në mungesë të konkurrencës së mirëfilltë, cilësia e shërbimeve të ofruara mund të jetë e nivelit të dobët dhe objektivat e organizatës të mos arrihen.

Rekomandimi 20 Kryetari duhet t'i rishikojë nevojat reale për angazhim të punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta. Nevoja për staf shtesë për pozitat e karrierës duhet të analizohet dhe nëse rritja e numrit të stafit është e domosdoshme, kjo të inkorporohet edhe në planifikimet buxhetore. Barrierat eventuale lidhur me rritjen e stafit, duhet të diskutohen edhe me Ministrinë e Financave dhe akterët tjerë.

Çështja 19 - Procedimi i parregullt i pagave - Prioritet i mesëm

E gjetura Në dy raste pagesa prej 1,517€ është bërë pas shkëputjes së kontratës. Pagesat e pa rregullta ishin pasojë e vonesës në procedimin e vendimeve me dy muaj vonesë, për t'i larguar me kohë zyrtarët nga lista e pagave.

Rreziku Zyra e personelit nuk ka azhurnuar dosjen e personelit dhe për pasojë ka ndodhë këto pagesa jo korrekte.

Rekomandimi 21 Kryetari duhet të zgjidhë këtë jokonsistencë, dhe të përcaktoj nëse këto janë vetëm raste të izoluara apo një dukuri e përhapur. Varësisht nga gjendja, të forcohen edhe kontrollet për të parandaluar rastet e tilla.

Çështja 20 - Dosje të pa kompletuara të personelit - Prioritet i mesëm

E gjetura Në 10 raste komuna nuk kishte arritur t'i kompletojë dosjet e personelit. Në dosjet mungonin dëshmitë mbi të dhënat personale për zyrtarët, përshkrimi i punës, certifikatat që nuk janë në hetime, etj. Gjithashtu, në dosje mungonin vlerësimet e performancës së zyrtarëve komunal në tre sektorët: administratë, arsim dhe shëndetësi.

Rreziku Dosjet e pa kompletuara rezultojnë me mungesën e informatave për të mundësuar menaxhim adekuat me burimet njerëzore në dispozicion. Vlerësimi i stafit pasqyron nivelin e kompetencës së stafit dhe nevojën për trajnime aty ku janë identifikuar dobësi.

Rekomandimi 22 Kryetari duhet të sigurojë që zyra e personelit do të aplikoj të gjitha kërkesat e rregulloreve të shërbimit civil për kompletimin e dosjeve, duke përfshirë edhe vlerësimet e rregullta të performancës për gjithë stafin.

Çështja 21 – Mungesa e kontratave për mësimdhënësit – Prioriteti i mesëm

E gjetura Në shtatë raste, kontratat për mësimdhënës kishin skaduar dhe të njëjtat nuk ishin ripërtëri nga nivelet kompetente të komunës, edhe pse të njëjtin vazhdojnë të punojnë dhe paguhen.

Rreziku Pagesat e stafit në bazë të kontratave të skaduara, konsiderohen si pagesa të parregullta. Për më tepër, angazhimi i stafit dhe moskryerja eventuale e detyrimeve për paga, rritë rrezikun që stafi të mos paguhet dhe mund të shkaktoj hapjen e kontesteve gjyqësore.

Rekomandimi 23 Kryetari duhet të marr masat për ripërtëritjen e kontratave si element bazë për vazhdimin e marrëdhënies së punës. Në të kundërtën, pagat nuk duhet të paguhen.

Çështja 22 – Parregullsi në përzgjedhjen e stafit në arsim dhe shëndetësi – Prioriteti i mesëm

E gjetura Me rastin e rekrutimit të stafit, komuna nuk kishte respektuar kërkesat e rregulloreve për rastet në vijim;

- Përzgjedhja e drejtorëve në katër shkolla: “Fan Noli”, “Ali Kelmendi”, “Naim Frashëri” dhe “Sami Frashëri”, është bërë në kundërshtim me UA 08/2014 të MASHT, ku kërkohet që kandidatët të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim dhe menaxhim. Komuna kishte dështuar të përcaktojë kriterin sipas këtij udhëzimi, edhe pse i njëjti konkurs ishte përsëritur.
- Në dy raste të rekrutimit në pozitën infermiere, komisioni intervistues nuk kishte bërë vlerësim objektiv pasi që certifikatat e trajnimit i kishte vlerësuar në kundërshtim me formularin e vlerësimit. Formulari i vlerësimit përcaktonte se për çdo certifikatë të trajnimit kandidati vlerësohet me 0.5 pikë. Komisioni në disa raste, certifikatën e kishte mbivlerësuar me 1 pikë.

Rreziku Përzgjedhja e kandidatëve në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe vlerësimi jo objektiv rrezikon trajtim të pabarabartë të kandidatëve, dhe rritë rrezikun e rekrutimit të stafit jo të duhur dhe jo meritore.

Rekomandimi 24 Kryetari të siguroj se proceset e rekrutimit do të bazohen në kritere të qarta të përzgjedhjes si dhe të demonstroj transparencë dhe objektivitet me rastin e selektimit të kandidatëve.

Çështja 23 - Largimi i punëtorëve nga puna pa bazë të arsyeshme ligjore - Prioritet i mesëm

E gjetura Me vendim të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, 18 shërbyes civil të larguar nga puna ishin kthyer në punë pas procedurës së ankesave. Këto veprime i kishin kushtuar komunës me kompensimin retroaktiv të pagave prej 37,427€.

Rreziku Largimi nga puna i punëtorëve në mënyrë arbitrare, mund të rezultojë me çrregullime të buxhetit për paga, duke shkaktuar pagesa të njëhershme dhe shpenzime shtesë për mbulimin e këtyre pozitave.

Rekomandimi 25 Me rastin e vendimmarrjes, lidhur me shkeljet e detyrave të punës nga ana e stafit, Kryetari të siguroj se janë zbatuar të gjitha procedurat e duhura dhe vendimmarrja është në përputhje të plotë me ligjet në fuqi.

3.5.3 Subvencionet dhe Transferet

Subvencionet ndahen kryesisht për entitete publike dhe entitete jo publike (individë), si: bursa për studentë dhe nxënës, subvencione për sport, ndihmë me ndërtime të shtëpive në emër të gjendjes së rëndë ekonomike, ndihma në ushqim për rastet emergjente dhe ndihma tjera sociale, subvencione në bujqësi, etj.

Rekomandimet

Çështja 24 - Parregullsi në pagesat për subvencione - Prioritet i lartë

E gjetura Pagesat për subvencione ishin përcjellë me dobësi si në vijim;

- OJQ Artpolis ishte subvencionuar me 3,500€ për mbajtjen e festivalit FEMFEST-it. Ekzekutimi i projektit nuk ishte kryer brenda afatit, dhe në këso raste, me kontratë parashihet ndërprerja dhe kthimi i parave;
- Dosjet për pagesë nuk ishin kompletuar në tetë raste. Atyre u mungonte kërkesa formale, rekomandimi nga komisioni pas shqyrtimit të kërkesës, projektet, raportet kthyesë, vendimi dhe kontrata. Fjala është për përfituesit: ODA - 3,000€; OVL-UÇK - 2,350€; APK - 4,000€; Klubit Hendbollistik - 13,000€; Sport Marketing - 10,000€; Trafiku Urban - 18,000€; studimi të florës dhe faunës - 15,000€; dhe ETEA - 5,000€;
- Në dy pagesa prej 18,000€ për Trafikun Urban, komuna kishte subvencionuar kompaninë për shpenzime të naftës, paga të punëtorëve dhe borxhe tjera. Lënda nuk ka të bashkangjitur rekomandimin e drejtores përkatëse, kontratën apo një raport kthyesë për paratë e harxhuara;
- Rasti për përkrahje "Studimi i florës dhe faunës në parkun Gërmia" në vlerë totale prej 15,000€ për dy persona pagesat nuk kanë të bashkangjitur rekomandimin, kërkesën formale, projektin dhe raportin

kthyes. Për me tepër, kontrata është lidhur pas përfundimit të studimit. Qëllimi i shpenzimit ishte shpallja e parkut të Gërmisë si pejsazh i mbrojtur kategoria e 5, që nuk përkon me qëllimin e subvencionimit sipas rregullores;

- Komuna kishte financuar "OVL-UÇK" në vlerë 2,350€ për projekte që kishin përfunduar. Subvencioni ishte kërkuar për shënimin e 18 Prillit - ditës së dëshmorëve të komunës, ndërsa pagesa ishte bërë në muajin qershor. Në rastin "APK-4,000€" për organizimin e panairit të librit 1-6 qershor të këtij viti, komuna kishte marr vendim dhe kishte lidhur kontratë me vonesë, dhe pagesa ishte bërë në muajin e Shtator, pasi që projekti kishte përfunduar. Pagesa për "ETEA-5,000€" ishte bërë në muajin gusht, edhe pse projekti - Dita botërore e muzikës në Prishtinë ishte realizuar në qershor;
- Subvencionimi për "Sport Marketing" në vlerë prej 10,000€ për aktivizimin sezonal të liqenit të Gërmisë, komuna nuk kishte pranuar një projekt, rekomandim nga komisioni, e as nuk kishte marrëveshje me përfituesin. Qëllimi i pagesës është mbulimi i borxheve për shkak të vështirësive financiare të kësaj kompanie që nuk përputhet me qëllimin e subvencionimit sipas rregullores;
- Subvencionimi për ekskursionin e shërbyesve civil në Durrës/Shqipëri në vlerë 5,000€ për shpenzime të akomodimit dhe transportit, nuk përputhet me qëllimin e subvencionimit;
- Rregullorja për subvencionim ishte përditësuar gjatë vitit të kaluar, mirëpo nuk përcakton kufirin se deri në çfarë shume kryetarit i lejohet të subvencionoj në mënyrë të pavarur, dhe shumat për të cilat duhet të vendos Kuvendi Komunal;
- Për pagesën prej 10,000€ për teatrin Dodona nuk ka projekt, nuk ka kërkesë, rekomandim të komisionit, dhe vendimi është për vlerën 20,000€, ndërsa pagesa është e pjesshme;
- Subvencioni për shoqatën e filozofëve të Kosovës në vlerë 1,000€, pagesa ishte bërë pas përfundimit të ngjarjes dhe nuk ka raport kthyes;
- Kryetari kishte marr vendim për subvencionim në vlerë prej 10,000€, edhe pse kërkesa nga orkestra kamertale ishte 5,940€. Për me tepër, është kërkuar mbulimi i shpenzimeve të mëditjes për 25*50€, akomodimi, biletat, telefonat, reklamat etj. dhe pagesa e kësaj të parë nuk ka të bashkangjitur raport kthyes;
- Një shumë prej 1,000€ është dhënë subvencion për botimin e një libri në llogarinë personale të përfitueses. Përfituesja e subvencionit nuk është banore e Prishtinës;

- Në dy pagesa prej 13,000€ për klubin hendbollistik “Prishtina”, mungon rekomandimi i komisionit, kërkesa formale dhe raporti kthyes; dhe
- Pagesa përfundimtare prej 17,979€ nga subvencionet sipas nenit 39.2 ishte bërë direkt nga thesari për shkak të vonesës në kryerjen e obligimit. Raporti i pranimit përfundimtar kishte aprovuar pagesën përfundimtare 18,256€ që ishte 568€ me të lart se kontrata dhe nuk ishte nënshkruar nga njëri anëtar.

Rreziku Mangësitë e identifikuar më lart tregojnë se kontrollet në fushën e subvencioneve nuk janë efektive. Si rezultat i kësaj, pagesat nuk janë mjaft të dokumentuara dhe të bazuara në rregullore. Ekziston rreziku që dhënia e mjeteve për subvencione të mos ketë arritur vlerën për para dhe qëllimet e subvencionimit.

Rekomandimi 26 Kryetari duhet të siguroj se rregullorja aktuale për subvencionet do të ndryshohet dhe plotësohet në pjesët ku janë identifikuar paqartësitë dhe të përcaktohen kriteret, kërkesat, procedurat dhe dokumentet e duhura për ndarjen dhe kontrollin e fondeve të dhëna për subvencione.

3.6 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Të hyrat e inkasuara nga komuna në vitin 2015 ishin 1,690,738€. Ato kanë të bëjnë me tatimin në pronë, lejet e ndërtimit, qiratë, ndërrim destinimin e tokës, shpronësimin, taksat administrative, etj.

Rekomandimet

Çështja 25 - Shfrytëzimi pa kontratë i apartamenteve të banimit – Prioritet i lartë

E gjetura Nga 43 shfrytëzues të objekteve banesore, 21 prej tyre janë staf i komunës dhe të pajisur me kontrata, ndërsa 22 qiramarrës tjerë (këshilltarë apo ish këshilltarë të kuvendit) nuk kishin kontrata, edhe pse me vite i shfrytëzojnë apartamentet komunale të banimit. Për më tepër, faturimi i qirasë nga ana e komunës nuk bëhet në baza mujore apo vjetore dhe pagesat bëhen në bazë të vullnetit të qiramarrësve.

Rreziku Komuna nuk ushtron kontrolle të mjaftueshme ndaj objekteve të saj banesore. Si rezultat i kësaj, pagesat janë çështje vullneti e qytetarëve dhe normat e inkasimit të qirave janë të ulëta. Kjo rritë rrezikun e mospagesës së obligimeve, dekurajimin e shfrytëzuesve që paguajnë me rregull dhe zvogëlon aftësinë e komunës për financimet e projekteve nga burimet vetjake.

Rekomandimi 27 Kryetari duhet t'i analizoj rastet e përmendura më sipër dhe të vendos kontrollet e duhura, që të gjitha pronat e dhëna me qira, të monitorohen në kuptimin e pagesës së qirasë në baza të rregullta mujore.

Çështja 26 - Parregullsi në dhënien e lejeve ndërtimore – Prioritet i lartë

E gjetura Procesi i dhënies së lejeve ndërtimore ishte përcjellë me dobësi si në vijim:

- Në pesë raste komuna kishte lëshuar aktvendime për caktimin e taksës së lejes së ndërtimit përderisa shqyrtimet e aplikacionit (kushtet ndërtimore, dizajnin mekanik, dizajnin e hidro instalimeve, projektimin e konstruksionit dhe dizajni elektrik) nuk ishin të përfunduara.
- Në një rast komuna kishte lëshuar lejen e ndërtimit pa pëlqimet e KEK-ut, KUR-it, dhe Termokosit; dhe
- Në tetë raste, komuna kishte shpronësuar toka, sipas vendimit duke e kompensuar atë me koeficient shtesë të ndërtimit në kundërshtim me planin rregullativ dhe ligjin e shpronësimit. Kjo vazhdon të bëhet duke u bazuar në një vendim nga Kuvendi Komunal i cili nuk është në harmoni me ligjin bazik të ndërtimit.

Rreziku Kriteret e pa plotësuar për dhënien e lejes rezultojnë me veprime të parregullta, trajtim jo të barabarta të aplikuesve dhe menaxhim të dobët, që bënë ndesh me kërkesat e planit rregullativ.

Rekomandimi 28 Kryetari duhet të siguroj respektimin e rregullave dhe kriterëve dhe të vendos kontrolle më efektive në sektorin e ndërtimit me qëllim të trajtimit të barabartë dhe respektim të ligjit. Gjithashtu, procesi i shpronësimit të bëhet në përputhje me rregullat.

Çështja 27 - Mos deponimi i të hyrave në llogari të komunës – Prioritet i lartë

E gjetura Biblioteka e qytetit "Hivzi Sylejmani" dhe teatri "Dodona" kanë arkëtuar të hyra prej 46,004€, të cilat nuk ishin deponuar në Llogarinë e Vetme të Thesarit, por në llogari të veçanta të menaxhuar nga ta. Në statutet e tyre, pasuria e këtyre institucioneve përcaktohet si pronë e komunës dhe për qarkullim financiar të tyre duhet të përdorin xhirollogarinë e komunës.

Rreziku Mos deponimi i të hyrave në Llogarinë së Vetme të Thesarit ndikon që shpenzimi i tyre të bëhet jashtë rregullave mbi shpenzimet e parasë publike dhe rrit rrezikun e keqmenaxhimit të tyre.

Rekomandimi 29 Kryetari duhet të forcoj kontrollet që të gjitha njësitë vartëse të komunës të derdhin të hyrat në Llogarinë e Vetme të Thesarit, me qëllim të evitimit të keqpërdorimi i tyre.

Çështja 28 - Inkasimi i të hyrave për pranim teknik pa bazë ligjore - Prioritet i lartë

E gjetura Në gjashtë raste, komuna ka arkëtuar taksën për pranim teknik të objektit, duke u bazuar në ligjin e vjetër të ndërtimit, rregulloret dhe udhëzimet administrative që derivojnë nga ky ligj. Të hyrat prej 161,234€, të cilat ishin destinuar për pagesë të komisioneve për pranim teknik, nuk kanë mbështetje ligjore. Të njëjtin aktivitet, komuna ngarkohet ta kryej përmes inspektoratit.

Rreziku Të hyrat e realizuara pa bazë ligjore rezultojnë me inkasime të paligjshme dhe dëmtim të investitorëve apo qytetarëve.

Rekomandimi 30 Kryetari të siguroj vendimmarrje ligjore në proceset e realizimit të të hyrave, dhe ngarkesa e qytetarëve të bëhet në përputhje të plotë me ligjet në fuqi.

Çështja 29 - Menaxhimi i garancioneve bankare për leje të ndërtimit - Prioriteti i Mesëm

E gjetura Në tri raste, sipas marrëveshjes me këste për pagesën e lejeve të ndërtimit, komuna nuk ka arritur të ekzekutoj garancinë bankare/polisat e sigurimit. Në njërin rast pagesa është bërë dy javë pas skadimit të polisës së sigurimit, rasti tjetër pagesa është bërë e pjesshme, ndërsa një garancion ende nuk është ekzekutuar.

Rreziku Mungesa e mekanizmave për menaxhimin e garancioneve, rrezikon arkëtimin me kohë të të hyrave dhe planin buxhetor të shpenzimeve.

Rekomandimi 31 Kryetari duhet të rishikoj kontrollet dhe të aplikoj aktivitete shtesë për ekzekutimin e garancioneve sipas marrëveshjes, me qëllim që inkasimi i të hyrave të bëhet me kohë.

Çështja 31 - Dobësi në menaxhimin e tatimit në pronë - Prioritet i mesëm

E gjetura Komuna nuk kishte verifikuar 1/3 e pronave të regjistruara që kërkohet me udhëzimin administrativ 03/2011. Verifikimi ishte bërë vetëm për 5,639 nga 81,181 prona të regjistruara apo 1/14 e tyre.

Rreziku Verifikimi jo i plotë i pronave sipas kërkesave ligjore mundëson paraqitjen e gabimeve në kalkulimin e vlerës së tatimit dhe mund të rezultojë me ngarkesa të parregullta për qytetarë.

Rekomandimi 32 Kryetari duhet të vendos kontrolle mbi verifikimin e pronave, ndryshimet të përcillen në kohë dhe ngarkesat për tatimpaguesit të jenë të sakta, me qëllim të realizimit korrekt të tatimit në pronë.

Çështja 31 - Dobësi në menaxhimin e zyrës së gjendjes civile - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Menaxhimi i zyrës së gjendjes civile ishte përcjellë me dobësitë si në vijim:
- Për nevoja tona të rishikimit, Zyra e ofiqarëve nuk ishte në gjendje të na ofroj fletëpagesat e taksave për shërbime. Ato ishin asgjësuar në mungesë të hapësirës për arkivim, që është në kundërshtim me rregulloren 01/2015 të MAP për ruajtjen e dokumenteve, ku afati për ruajtjen e dokumente të ofiqarisë është 5 vite;
 - I njëjti zyrtar pranon kërkesën, ekzekuton pagesën dhe lëshon çertifikatën, që bie ndesh me procedurat e menaxhimit financiar dhe kontrollit për ndarje të drejtë të detyrave; dhe
 - Të gjithë ofiqarët (16), që inkasojnë pagesat në emër të taksave, nuk bëjnë deponimin në bankë në baza ditore të mjeteve të inkasuara nën 10€, siç është e paraparë me rregullën financiare 01/2013.

Rreziku Asgjësimi i dokumentacionit, ndarja jo e drejtë e detyrave dhe mos dorëzimi i mjeteve nën 10€ në fund të ditës, rrit rrezikun e keqpërdorimeve apo humbjes së parasë publike.

Rekomandimi 33 Kryetari duhet t'i rishikojë kontrollet mbi menaxhimin e procesit të të hyrave nga ofiqaritë dhe të vendos kontrollet e duhura me qëllim të parandalimit të mundësisë për keqpërdorime.

3.7 Pasuritë dhe detyrimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuritë e komunës të regjistruara në SIMFK dhe të prezantuara në PVF kanë vlerën 111,035,848€. Vetëm këtë vit vlera e pasurisë rishtazi e regjistruar ishte 15,806,263€. Menaxhmenti gjatë vitit të kaluar kishte zhvilluar aktivitetet me projektin DEMOS për identifikim të pronave, mirëpo nuk kishte arritur të përcaktojë vlerat reale të pasurive.

Rekomandimi

Çështja 32 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë - Prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna nuk ka zbatuar kërkesat e Rregullës Financiare 02/2013 për menaxhimin e pasurisë, që ka rezultuar me dobësitë në vijim:
- Vlera e pasurisë prej 2,468,437,496€, të vlerësuar nga komisioni i datës 07.11.2012 ende vazhdon të paraqitet si shpalosje, mirëpo nuk ishte regjistruar në SIMFK deri në fund të periudhës raportuese. Gjatë kohës sa
-

ne ishim në auditim (10.05.2016) komuna kishte filluar të regjistroj këtë pasuri dhe kjo çështje do të jetë objekt auditimi për vitin e ardhshëm;

- Komuna nuk kishte arritur të vlerësoj dhe regjistroj 5,904 prona në 40 zona kadastrale, të identifikuar nga raporti i projektit DEMOS;
- 43 objekte komunale banesore të dhëna në shfrytëzim nuk janë përfshirë në regjistra të pasurisë;
- Mos përdorimi i modulit e-pasuria ka reflektuar që vlera e pasurisë jo-kapitale nën 1,000€, të jetë e mbivlerësuar, për shkak të mos aplikimit të normave të zhvlerësimit vjetor;
- Kryetari nuk kishte formuar komisionin e vlerësimit dhe të inventarizimit të pasurisë për vitin 2015, megjithatë inventarizimi ishte bërë nga 11 komisione që ishin përcaktuar nga drejtorët e drejtorive përkatëse; dhe
- Klasifikimi i pasurisë i regjistruar në SIMFK krahasuar me shpalosjen në PVF, si pasojë e gabimeve teknike jep një pamje të pa qartë të pasurisë ndër vite.

Rreziku

Mos vlerësimi i pronave dhe mungesa e formimit të komisioneve për vlerësim dhe inventarizim të pasurisë, është në kundërshtim me rregullën 02/2013 dhe mund të shpie në tjetërsim ose humbje të pasurisë. Për më tepër, shpalosja jo e saktë e pasurive komunale shpie në keqkuptim të pozitës financiare dhe mund të rezultojë me Theksim të Çështjes apo modifikim të opinionit.

Rekomandimi 34 Kryetari duhet t'i rishikojë kontrollet lidhur me menaxhimin e pasurive dhe të sigurojë regjistrim të saktë dhe të plotë të tyre. Çështja e pasurive të identifikuara, por të pa regjistruara në SIMFK, duhet të diskutohet me Ministrinë e Financave dhe të gjinden modalitetet për përfshirjen e tyre në sistem.

3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Llogaritë e arkëtueshme të komunës prezantojnë shuma të mjeteve që qytetarët dhe organizatat i detyrohen komunës për shërbimet që i kanë përfituar nga komuna. Komuna ka prezantuar të arkëtueshmet në vlerë 50,332,475€, krahasuar me vitin paraprak prej 43,172,000€. Të arkëtueshmet këtë vit tregojnë një trend në rritje të këtyre llogarive. Kjo, për shkak të politikave jo-efektive të zbatuara nga menaxhmenti dhe mungesës së një strategjie për inkasimin e këtyre borxheve

Rekomandimi

Çështja 33 - Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i lartë

E gjetura Përkundër faljes së borxheve për tatim në pronë, vlera e llogarive të arkëtueshme vazhdon të jetë e lartë. Komuna kishte nënvlerësuar të arkëtueshmet nga lejet e ndërtimit për 80,473€. Gjithashtu, të arkëtueshmet nga ushtrimi i veprimtarive shërbyese në vlerë prej 295,611€ dhe të çerdheve për 1,275€ të siguruar nga raportet e departamenteve nuk ishin prezantuar në PVF. Në total kjo kategori ishte nënvlerësuar për 377,360€.

Rreziku Mungesa e mekanizmave dhe e kontrolleve adekuate rritë rrezikun për rritje të vazhdueshme të këtyre llogarive, që rezulton me më pak fonde për arritjen e objektivave dhe nxit debitorët tjerë të mos paguajnë obligimet e tyre. Për më tepër, vjetërsimi i pakontrolluar i tyre mund të rezultojë me shndërrim në borxhe të këqija dhe pamundësi për t'i arkëtuar. Evidentimi dhe shpalosja jo adekuate rezulton me menaxhim të dobët dhe transparencë të ulët.

Rekomandimi 35 Kryetari duhet t'i analizojë arsyet e trendit të rritjes së këtyre llogarive dhe t'i forcojë kontrollet për të parandaluar rritjen e tyre të mëtutjeshme. Një strategji dhe mekanizma adekuat duhet të vendosen për të mundësuar identifikimin dhe arkëtimin e borxheve të akumuluar, përfshirë edhe veprimet ligjore.

3.7.3 Trajtimi i borxheve (detyrimeve)

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 1,142,513€ për afërsisht e njëjtë me vitin e kaluar. Këto detyrime që shumica i takojnë mallrave/shërbimeve dhe investimeve kapitale janë bartur për t'u paguar në vitin 2016. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të komunës.

Përveç borxheve, komuna ka detyrime kontingjente lidhur me konteste të ndryshme gjyqësore që parallogariten në vlerë rreth 8,298,000€, që krahasuar me vitin e kaluar (3,110,000€) kanë një tendencë rritëse. Komuna është duke e zhvilluar çasjen e saj për trajtimin e këtyre detyrimeve dhe e ka të qartë mundësinë e shndërrimit të detyrimeve kontingjente në obligime faktike dhe keqësimit të situatës financiare të komunës.

Rekomandimi

Çështja 34 - Obligimet e papaguara - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna ka hyrë në obligime financiare në kundërshtim e 36.1 dhe 37.1 të LMFPP ku thuhet se organizata buxhetore nuk duhet të krijoj asnjë obligim gjatë vitit aktual fiskal në një shumë që i tejkalon fondet e ndara. Nga totali i detyrimeve të paraqitura, 215,159€ janë obligime më të vjetra se 30 ditë. Kjo është në kundërshtim edhe me Rregullën Financiare Nr. 01/2013 - Shpenzimi i parave publike. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016 si ngarkesë shtesë e buxhetit. Përveç kësaj ne kemi identifikuar se pesë fatura në vlerë prej 1,360€ dhe nuk janë shpalosur si detyrime të papaguara për 2015.

Rreziku Si pasojë e hyrjes në obligime të pa mbuluara financiare, mund të dobësohet aftësia për planifikim dhe menaxhim të nevojës për likuiditet, dhe komuna mund të përballet me kosto shtesë të interesave dhe gjobave për vonesat e shkaktuara ndaj palëve.

Rekomandimi 36 Kryetari duhet të siguroj veprime konkrete që departamenti i financave të evidentoj dhe paguaj me kohë të gjitha detyrimet, ndërsa detyrimet kontingjente të trajtohen me kujdes me rastin e planifikimeve të ardhme buxhetore.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

| Komponenti i Auditimit | Rekomandimet e dhëna | Rekomandimet e implementuara | Rekomandimet pjesërisht të adresuara | Rekomandimet e pa adresuara |
|---|--|------------------------------|--------------------------------------|-----------------------------|
| 1. Mos regjistrimi i të gjitha pasurive mund të rezultojë në nënvlerësim material të vlerave të pasurive në PVF | Kryetari i Komunës duhet të siguroj vazhdimin e procesit të regjistrimit të të gjitha pasurive. Një rol kyç në këtë proces duhet të ketë Drejtoria e Kadastrit, duke siguruar/ofruar të gjitha të dhënat mbi pronat publike në posedim të komunës. Bazuar në këtë, një komision i veçantë duhet të bëjë një vlerësim dhe një raport t'ia dorëzoj zyrtarit të pasurive për t'i proceduar regjistrimet e duhura në sistemin e SIMFK (moduli i pasurive). Në fund të vitit duhet të kryhet inventarizimi i tërësishëm për të konfirmuar ekzistencën e pasurive (në veçanti të pasurive të luajtshme) si dhe të funksionalizoj përdorimin e modulit E-pasuria për të konfirmuar saktësinë dhe plotësinë e pasurive nën 1,000€. Të gjitha aktivitetet duhet të kryhen para se PVF-të e vitit 2015 të jenë dorëzuar. | | Pjesërisht e adresuar | |
| 2. Pasqyrave Financiare | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i hartimit të PVF-ve për 2015 të përfshijë një rishikim kritik nga menaxhmenti të draft pasqyrave, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet përveç nëse në draft PVF janë zbatuar kontrollet e nevojshme. | | Pjesërisht e adresuar | |
| 3. Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga ZAP-i dhe atyre të pa adresuara, të zbatohet me staf përgjegjës dhe me fokus fillestar në ato të një rëndësie më të madhe. | | Pjesërisht e adresuar | |

| | | | | |
|--|--|--|-----------------------|--------------|
| 4. Qeverisja e mirë | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë një rishikim të kualitetit të aranzhimeve ekzistuese të qeverisjes/llogaridhënies në komunë dhe kërkesat e ndërlydhura për raportim të tyre. Kërkesat e pa plotësuara duhet të zbatohen deri në fund të vitit 2015, duke përfshirë edhe statutin e Komitetit të Auditimit për të siguruar efektivitetin e tij duke demonstruar pranë Asamblesë Komunale ndryshimin e praktikave për të siguruar menaxhim efektiv operacional të komunës si një bazë për arritjen e objektivave strategjike. | | Pjesërisht e adresuar | |
| 5. Ekzekutimi i buxhetit | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë një monitorim sistematik të performancës buxhetore në baza mujore si dhe t'i identifikojë dhe adresojë pengesat në përmirësimin e nivelit të ekzekutimit të buxhetit dhe në përdorimin efektiv të të hyrave vetjake. Nëse supozimet fillestare buxhetore janë të pasakta, ato duhet të rishikohen në pozitën e buxhetit final. Kryetari i Komunës duhet po ashtu të inicojë një analizim të arsyeve të mospërputhjes midis planifikimit dhe faturimit për tatimin në pronë dhe të sigurojë që planifikimi i të hyrave është i bazuar në vlerësime reale të detyrimeve tatimore. | | Pjesërisht e adresuar | |
| 6. Keq klasifikimi i shpenzimeve | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që arsyet e keq klasifikimeve do të identifikohen dhe t'i forcojë kontrollet në mënyrë që të gjitha shpenzimet planifikohen dhe klasifikohen në kodet/kategoritë e duhura me synimin që këto të paraqiten drejtpërdrejt në PVF. | | | Pa adresuara |
| 7. Menaxhimi i të hyrave nga tatimi në pronë | Kryetari i Komunës duhet t'i analizojë arsyet se pse janë lëshuar vërtetime për tatim në mungesë të pagesave për tatim dhe t'i forcojë kontrollet duke siguruar që vërtetimet do të lëshohen vetëm pas përmbushjes së plotë të kriterëve për pagesë. | | Pjesërisht adresuar | |

| | | | | |
|---|---|-----------------|-----------------------|-------------|
| 8. Pronat e dhëna me qira | Kryetari i Komunës duhet t'i përcaktojë arsyet për kontrollet e dobëta mbi menaxhimin e të hyrave nga qiraja dhe t'i forcojë kontrollet për të siguruar që të gjitha qiratë të pasqyrojnë kontratat formale dhe çmimet e tregut deri në fund të vitit 2015. Një listë e plotë dhe e saktë e të gjithë shfrytëzuesve me shumat që i kanë borxh komunës duhet të përpilohet dhe duhet identifikuar kërkesat për pagesa dhe të njëjtat të implementohen. | | | Pa adresuar |
| 9. Lejet e ndërtimit | Kryetari i Komunës duhet të përcaktoj se pse janë paraqitur dështimet e identifikuar në lidhje me lejet për ndërtim dhe duhet të implementoj kontrole të përmirësuara për të siguruar që në të ardhmen, rregullat dhe tarifrat aplikohen drejtë. | | Pjesërisht e adresuar | |
| 10. Dobësi sistematike në prokurim | Kryetari i Komunës duhet të përcaktoj se pse nuk janë ndjekur kërkesat për prokurim në rastet e identifikuar dhe të aplikoj kontrole të përmirësuara që të siguroj që dobësitë sistematike janë identifikuar dhe janë adresuar. Të gjitha ndërtimet duhet të bëhen vetëm nëse ekzistojnë projekte të duhura ndërtimi. | | Pjesërisht e adresuar | |
| 11. Dobësitë jo-sistematike të prokurimit | Kryetari i Komunës duhet të iniciojë një rishikim të praktikave të aplikuara të prokurimit në këto raste dhe të zbatojë kontrole të forcuara të cilat sigurojnë se prokurimet e sigurojnë aftësinë e kontraktorëve për t'i përfunduar kontratat; faturat i pasqyrojnë shumat aktuale të borxheve; dhe që nuk është aplikuar kuotimi i çmimeve - me përjashtim të rrethanave të caktuara. | | Pjesërisht e adresuar | |
| 12. Trajtimi i bashkëfinancimeve | Kryetari i Komunës duhet të përcaktojë se pse kanë dështuar aranzhimet për menaxhim të projektit në këtë rast dhe të zbatojë aranzhime të përmirësuara në lidhje me bashkëfinancimet për të siguruar se nuk do ketë humbje të financimeve nga jashtë. | I implementuar. | | |

| | | | | |
|--|--|--|--|--------------|
| 13. Avanset | Kryetari i Komunës duhet të përcaktojë se pse ky avans nuk ka qenë subjekt i kontrolleve të përshtatshme në përputhje me kërkesat ligjore dhe duhet t'i forcoj kontrollet për të siguruar që një veprim i tillë nuk përsëritet. Marrëveshjet për bashkë-financim duhet t'i pasqyrojnë marrëveshjet kontraktuale të cilat komunës i ofrojnë monitorimin efektiv për progresin e projektit. | | | Pa adresuara |
| 14. Drekat zyrtare dhe udhëtimet zyrtare | Kryetari i Komunës duhet të sigurohet që kontrollet mbi shpenzimet për dreka zyrtare janë forcuar. Të gjitha pagesat për dreka zyrtare duhet të mbështeten me informata dhe dëshmi rreth pjesëmarrësve dhe qëllimit të organizimit. | | | Pa adresuar |
| 15. Kontratat për shërbime të veçanta | Kryetari i Komunës duhet t'i rishikojë nevojat për angazhim të punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta dhe t'i forcojë kontrollet lidhur me angazhimin dhe monitorimin e këtyre punëtorëve. Asnjë pagesë s' duhet t'iu bëhet punëtorëve pa kontrata. Kryetari duhet ta shqyrtojë mundësinë për shtimin e punëtorëve të karrierës për pozitat kyçe të komunës. Kryetari duhet të sigurojë një analizë të efektivitetit mes angazhimit të punonjësve të pastrimit/rojeve dhe shërbimet jashtë kontraktuale. | | | Pa adresuar |
| 16. Parregullsi në menaxhimin e listës së pagave | Kryetari i Komunës duhet inicioj një rishikim të kontrolleve mbi listën e pagave dhe të analizojë arsyet që kanë shkaktuar parregullsitë e identifikuar. Kryetari duhet të sigurojë që të forcohen kontrollet mbi listën e pagave për të siguruar aplikim efektiv të rregullave përkatëse. | | | Pa adresuar |
| 17. Dosjet e personelit | Kryetari i Komunës duhet të iniciojë një rishikim sistematik të dosjeve të personelit për të siguruar që të gjitha informatat e nevojshme janë përfshirë brenda një periudhe të caktuar kohe. Përveç kësaj, të marrë konfirmimin se sistematizimi i pozitave kontraktuale të mësuesve, të cilave po u referohemi më sipër, duhet të konsiderohen. | | | Pa adresuar |

| | | | | |
|--|---|--|-----------------------|-------------|
| 18. Mungesë e raporteve kthyesë prej përfitueseve | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të gjitha subvencionet janë subjekt i monitorimit efektiv dhe se aty ku kërkesat nuk respektohen merren masa adekuate si është pezullimi i pagesave. | | | Pa adresuar |
| 19. Dobësi në regjistrimin e pasurive gjatë vitit 2014 | Kryetari i Komunës duhet të inicioj një analizë për pengesat të cilat kanë parandaluar aplikimin e plotë të Rregullës Financiare 02/2013 gjatë vitit 2014 dhe të implementoj procedura të domosdoshme për të siguruar regjistrim të plotë dhe të saktë të të gjitha pasurive. | | Pjesërisht e adresuar | |
| 20. Nivel i lartë i të arkëtueshmeve | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë një vlerësim i të arkëtueshmeve historike është përfunduar duke i identifikuar dhe dokumentuar rastet që mund të trajtohet si borxh i keq dhe të bëjë shlyerjen e tij. Pjesa e mbetur e borxheve, barrierat në inkasim duhet të adresohen përmes mekanizmave adekuat përfshirë veprimet ligjore. | | | Pa adresuar |
| 21. Përfitim i dobët nga NjAB | Kryetari i Komunës duhet të vendosë funksionim të plotë të Sistemit të Auditimit të Brendshëm dhe të siguroj numrin dhe kualitetin e duhur të auditimit të brendshëm Kjo duhet ta pasqyrojë një zbatim në tërësi të rrezikut të bazuar në Auditimin Strategjik dhe Planin Vjetor dhe statutin e KA-së. Kryetari duhet të përcjellë implementimin e sistemit dhe rezultatin e tij. | | | Pa adresuar |